



VENDIMI DHE GJETJET

Data e miratimit: 4 qershor 2020

Nr. i lëndës: 2016-17

Milijana Avramović

kundër

EULEX

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur më 4 qershor 2020, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaël METTRAUX, kryesues
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare
Znj. Anna AUTIO, anëtare

Ndihmuar nga:

Z. Ronald Hooghiemstra, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 11 dhjetor 2019,

Pas shqyrtimit përmes mjeteve elektronike, në përputhje me Rregulloren 13(3) të Rregullores së Punës së Panelit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa në këtë lëndë është regjistruar më 30 qershor 2016.
2. Përmes letrës së datës 1 korrik 2016, Paneli ka informuar Misionin se kjo lëndë ishte e regjistruar.
3. Më 28 qershor 2017, Paneli i ka kërkuar ankueses që të sigurojë informata shtesë në lidhje me ankesat e saj.
4. Më 20 shtator dhe 17 tetor 2017, Paneli ka dërguar dy kërkesa të tjera për informacion shtesë. Paneli nuk mori asnjë përgjigje në lidhje me këtë lëndë.
5. Më 8 dhjetor 2017, Paneli i ka përcjellë deklaratën e fakteve dhe pyetjeve shfes së Misionit (ShM-së), EULEX-i Kosovë, duke e ftuar atë të paraqiste përgjigjet dhe vërejtjet e saja me shkrim për ankesat deri me datën 26 janar 2018.

6. Përmes letrës së datës 17 janar 2019, nga Misioni ishte kërkuar që përsëri të ofronte përgjigje për pyetjet deri më 16 shkurt 2019.
7. Përmes letrës së datës 8 prill 2019, Paneli përsëri i kërkoj ShM-së që të sigurojë përgjigje për pyetjet sa më shpejt që është e mundur.
8. Me datën 20 qershor 2019, ankuesja ishte informuar që Paneli ishte ende në proces të shqyrtimit të ankesës së saj.
9. Vërejtjet e ShM-së përfundimisht ishin marrë me datën 30 korrik 2019, pas së cilës ato iu komunikuan ankuesve për vërejtje shtesë.
10. Më 5 gusht 2019, komentet e ushtruesit të detyrës së ShM-së iu dërguan ankueses, dhe asaj iu kërkuar të paraqiste komentet e veta, nëse kishte ndonjë, jo më vonë se me datën 6 shtator 2019. Ajo nuk e shqyrtoj atë mundësi.
11. Më 11 dhjetor 2019, Paneli gjeti se lënda ishte e pranueshme (<https://hrrp.eu/alb/docs/Decisions/2019-12-11%20Admissibility%20Decision%202016-17-a.pdf>) në lidhje me shkeljet e pretenduara të neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në atë vendim, Paneli u kërkoj palëve t'i adresojnë pyetjet e mëposhtme:

1. **Për ankuesin:** Ju lutemi ofroni informacione që kanë të bëjnë me pyetjet në vijim:

- i. Çfarë kontakti, nëse ka pasur, keni pasur ju me Misionin e EULEX-it apo me përfaqësuesit e tij?
- ii. A jeni në dijeni për ndonjë përpjekje nga autoritetet vendore për ta hetuar këtë rast?
- iii. A ka bërë shkelje apo a ka kontribuar Misioni në shkeljen e të drejtave të ankuesit sipas neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës? Nëse po, në çfarë mënyre?
- iv. Cilat janë pasojat personale, financiare, ligjore dhe emocionale që lidhen me zhdukjen e të afërmit tuaj?

2. **Për Misionin:** Ju lutemi ofroni informacione që kanë të bëjnë me pyetjet në vijim:

- i. Pse NjHKL-ja nuk e përcolli kërkesën e prokurorit të NjSRK-së (shih më lartë par. 32, Vendimin e Pranueshmërisë)? Në dijeninë tuaj, a kishte komunikim të mëtejshëm midis tyre lidhur me këtë çështje?
- ii. Pse Misioni nuk u përpoq të kontaktojë të afërmit e z. Avramović?
- iii. A e ka konsideruar Misioni që t'i informonte rreth ekzistencës së këtyre dosjeve të afërmit e atyre që janë zhdukur, dosjet e të cilëve u janë bartur autoriteteve vendore të Kosovës?
- iv. A është marrë parasysh mundësia që të afërmit e të zhdukurve të kenë qasje në to, dhe nëse po, kushtet në të cilat kjo mund të ndodhë dhe përmes cilave autoritete?

- v. Parashtrësat e Misionit të datës 30 korrik 2019 tregojnë se shënimi për dorëzimin e dokumenteve i adresuar ish kryeprokurorit të ZSRK-së përmbante një ftesë që të bëhej ndërlidhja me NjHKL-në e EULEX-it në lidhje me veprimet e ndërmarra rreth kërkesës për të kryer një hetim të korrikut të vitit 2009. Cilave 'veprime' i referohet ky shënim? A ka kryer Misioni veprime hetimore në lidhje me këtë rast dhe nëse po, cilat veprime?
 - vi. A u janë përgjigjur autoritetet vendore ftesës së Misionit të përfshirë në shënimin e dorëzimit të dokumenteve që i përket këtij rasti? Nëse po, a kanë kërkuar ndihmën e Misionit?
 - vii. A ka shkelur apo kontribuar Misioni në shkeljen e të drejtave të ankuesit sipas neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës? Nëse po, në çfarë mënyre?
12. Nga palët është kërkuar që t'i ofrojnë parashtrësat e tyre në lidhje me meritat e lëndës deri më 16 mars 2019. Palëve iu kërkuar që të bëjnë parashtrësat e tyre jo më vonë se me datën 16 mars 2020. Në atë kohë, ishin të vendosura masat kufizuese të lidhura me pandeminë korona. Asnjë parashtrim i ri nuk u pranua nga ankuesi.
13. Për shkak të pandemisë së virusit korona dhe si rezultat i pezullimit të shërbimeve postare, është e mundur që ankuesi nuk ka qenë në gjendje të dërgojë parashtrësën shtesë në Panel. Për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme të krijuara nga situata aktuale sanitare dhe duke qenë i bindur që Paneli mund të procedojë pa shkaktuar dëm ndaj ankuesit, Paneli ka vendosur të marrë vendimin e tij pa vonesë për të siguruar që procedurat të zhvillohen në mënyrë të shpejtë.

II. FAKTET

14. Faktet e çështjes, siç paraqiten nga ankesa, mund të përmbliidhen si më poshtë.
15. Më 19 qershor 1999, rreth orës 07.30, bashkëshorti i ankueses, Milorad Avramović, ishte rrëmbyer me katër burra të tjerë dhe një grua në rrugën Shën Starca Vujadina 3/1, Tamnik, në Mitrovicë. Në kohën e rrëmbimit të tij, ai ishte duke e ndihmuar me kamion gruan e lartpërmendur për të ndërruar shtëpinë nga jugu i Mitrovicës në veri të Mitrovicës.
16. Personat e rrëmbyer ishin dërguar në një shtëpi tjetër afër në Tamnik, Mitrovicë, ku u morën në pyetje për disa orë. Tre nga burrat dhe gruaja u lanë të lirë nën kujdesin e ushtarëve të KFOR-it. Ushtarët e KFOR-it kontaktuan me policinë e UNMIK-ut, të cilët i dërguan në veri të Mitrovicës. Milorad Avramović-i dhe vozitësi i kamionit u mbajtën gjatë natës. Drejtuesi i automjetit u la i lirë mëngjesin tjetër. Që atëherë nuk ka asnjë gjurmë të Milorad Avramović-it.
17. Ankuesi ka raportuar zhdukjen në UNMIK, KFOR, KNKK dhe organizatat joqeveritare vendore në Mitrovicë.
18. Më 14 qershor 2000, motra e Milorad Avramović-it dha një deklaratë të dëshmitarit për zhdukjen e vëllait të saj tek një gjykatës hetues në gjykatën e qarkut në Leskovc, Republika e Serbisë. Kjo deklaratë dhe informacione të tjera me rëndësi janë të përfshira në dosjen e lëndës.

III. PARASHTRESAT NGA PALËT

Ankuesja

19. Siç përmbledhet më lartë, ankuesja pretendon se EULEX-i Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv duhej të kishte hetuar zhdukjen e bashkëshortit të saj dhe me faj nuk e ka bërë atë në kundërshtim me të drejtat themelore të tij dhe të bashkëshortit të saj.

Shefi i Misionit (“ShM”)

20. Parashtrësats e Misionit në lidhje me meritat e kësaj lënde u pranuan më 27 prill 2020.
21. Në përgjigje të pyetjes së Panelit se pse Misioni/NjHKL nuk kishte përcjellë kërkesën e ZPSRK-së të datës 23 korrik 2009 që NjHKL të bënte një hetim të këtij rasti, Misioni tha si në vijim. Kjo kërkesë ishte një nga 900 kërkesa të ngjashme të lëshuara nga NjHKL e EULEX-it. Misioni shtoi:

‘Bazuar në informacionin e disponueshëm, EULEX-i përfundon se NjHKL nuk ishte në gjendje të përcjellë tutje këtë kërkesë të veçantë për të kryer një hetim, sepse prioritizonte raste të tjera që ishin më premtuese për sa i përket rezultateve hetimore. Misioni e kupton që kjo duhet të jetë jashtëzakonisht shqetësuese dhe zhgënjyese për znj. Avramović dhe me keqardhje të thellë për këtë. Sidoqoftë, duke pasur parasysh sasinë masive të lëndëve dhe dokumenteve të dorëzuara nga UNMIK-u, Misioni nuk kishte zgjidhje tjetër përveç se të përcaktonte prioritetet të caktuara ndaj të tjerëve. Në dijeninë e Misionit nuk ka pasur komunikim të mëtejshëm midis ZPSRK-së dhe NjHKL-së në lidhje me kërkesën për të kryer një hetim të korrikut 2009.’

22. I pyetur pse Misioni nuk kërkoi të kontaktonte të afërmit e të zhdukurve, Misioni u përgjigj se pasi që nuk mundi ta përcillte kërkesën për hetim të vitit 2009, ai nuk kërkoi t'i kontaktonte ata.
23. Lidhur me mundësinë që Misioni të informojë të afërmit rreth të zhdukurve, dosja e të cilëve u ishte bartur autoriteteve vendore, autoriteteve të Kosovës, Misioni tha që nuk konsideronte se ishte e domosdoshme ta bënte këtë. Për më tepër, Misioni pohoi se 'kjo gjithashtu do të ishte një detyrë e pamundur administrative për t'u përmbyllur brenda afatit të dhjetorit 2018. Nëse znj. Avramović kishte kontaktuar EULEX-in ose stafin e regjistrimit të PSRK-së, ajo do të ishte informuar për ekzistencën e dosjes së lëndës’.
24. I pyetur nëse i ishte kushtuar vëmendje mundësisë për t'u dhënë të afërmit të të zhdukurve qasje në dosjet e lëndës, Misioni thotë se që nga qershori 2018, dosjet duhet t'u kërkohej institucioneve të Kosovës. Paneli e merr këtë përgjigje si një indikacion që, përpara qershorit 2018, Misioni nuk e kishte konsideruar atë mundësi.
25. Parashtrësats e Misionit të datës 30 korrik 2019 treguan që ato që iu adresuan (atëherë) kryeprokurorit të ZPSRK-së përmbanin një hetim për t'u ndërlidhur me NjHKL-në e EULEX-it në lidhje me veprimet e ndërmarra në lidhje me kërkesën për të kryer një hetim të korrikut 2009. Paneli i kërkoi Misionit të shpjegojë se cilat 'veprime' kishte të bënte shënimi dhe nëse Misioni kishte kryer veprime hetimore në lidhje me këtë rast dhe nëse po, cilat veprime. Në përgjigje të tij, Misioni tha që ftesa ishte përfshirë për të siguruar që çdo veprim i mundshëm i ndërmarrë përpara dorëzimit do t'u komunikohet institucioneve të Kosovës dhe gjithashtu që çdo material i mëtejshëm i disponueshëm në NjHKL do t'u

transmetohej këtyre autoriteteve. Për dijeninë e Misionit - asnjë veprim i tillë nuk u ndërmor nga NjHKL-ja në lidhje me kërkesën për të kryer një hetim të korrikut 2009”.

26. Në pyetjen nëse autoritetet vendore kishin reaguar ndaj ftesës së Misionit, Misioni u përgjigj se lënda ishte caktuar në fund të prillit 2018 tek një prokurori të Kosovës në PSRK dhe inkurajoi ankuesin që të kërkojë informata tek autoritetet e PSRK-së.
27. I pyetur nëse Misioni kishte shkelur të drejtat e ankuesit në bazë të neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës, Misioni së pari sqaron se nuk e konteston kompetencën *ratione materiae* të Panelit mbi këtë rast (megjithëse vetëm sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës). Paneli vëren se Misioni nuk shpjegon pse Paneli nuk do të kishte juridiksion mbi nenet 8 dhe 13 në bazë posaçërisht të parimit se varet nga Paneli që të përcaktojë se çfarë dispozite ligjore mund të jetë e zbatueshme (*jura novit curia*) dhe fakti që lënda ishte shpallur e pranueshme në lidhje me të katër të drejtat. Shih në përgjithësi, 2016-23, Vendimi i Pranueshmërisë, paragrafët 40-42. Duke mos bërë parashtrësia në lidhje me dy të fundit të këtyre të drejtave, Paneli e konsideron Misionin se kishte hequr dorë nga e drejta e tij për ta bërë këtë.
28. Misioni gjithashtu pranon se “ankuesja ka të drejtë për një hetim efektiv për zhdukjen e bashkëshortit të saj”. Sidoqoftë, Misioni shton, garancia procedurale e përfshirë në nenin 3 të Konventës është një nga “mjetet” dhe jo rezultat. Thelbësore për atë vlerësim, Misioni sugjeron, është pyetja nëse autoritetet “kanë bërë gjithçka që mund të pritej në mënyrë të arsyeshme prej tyre në rrethanat e lëndës” (duke iu referuar lëndëve të KEDNj-së të *Trivkanovic*, paragrafi 78; *Borojevic*, par. 57; dhe *Njezic*, paragrafi 69). Për më tepër, ai thotë, 'natyra dhe shkalla e shqyrtimit duhet të vlerësohet në bazë të të gjitha fakteve përkatëse dhe në lidhje me realitetet praktike të punës hetimore' (duke iu referuar dhe duke u mbështetur në rastet e KEDNj-së: *Cindric* dhe *Beslic*, par. 69; *Zdjelar*, par. 83; *Velcea* dhe *Mazare*, paragrafi 105; dhe *Armani da Silva*, paragrafi 234).
29. Mbi këtë bazë, Misioni fton Panelin në veçanti që të marrë parasysh –
 - a) shkallën e krimeve në fjalë (në veçanti, fakti që konflikti ka shkaktuar rreth 13,000 viktima) që do të thotë se jo të gjitha krimet mund të hetohen ndonjëherë; dhe
 - b) gjendjen e dosjeve të trashëguara nga UNMIK-u. Në këtë drejtim, Misioni tregon në lidhje me natyrën e pamjaftueshme dhe jo të plotë të të dhënave që janë ofruar nga UNMIK-u, e cila kërkon që Misioni të investojë shumë kohë dhe burime në rishikimin dhe organizimin e tyre. Për rastin e z. Avramović, për shembull, dokumentet u ndanë në pjesë të ndryshme: ekzistonte një dosje e Policisë për 'krime lufte', një dosje për 'personat e zhdukur' dhe kopjet e dokumenteve të mbajtura në Departamentin e Mjekësisë Ligjore (më vonë Instituti i Mjekësisë Ligjore) Mjekësia - IFM).

Si rezultat, Misioni sugjeron që kur, në korrik 2009, prokurori i NjHKL-së të EULEX-it lëshoi një kërkesë për të kryer hetime, "ajo ka shumë të ngjarë të mos ishte në dijeni se dokumente të tjera që kanë të bëjnë me zhdukjen e Milorad Avramović ishin në dispozicion, të tilla si ato nga dosjet për 'personat e zhdukur' dhe ato të mbajtura në DFM/IFM”.

30. Mbi këtë bazë, Misioni fton Panelin të sigurojë që vlerësimi i tij për atë që mund të bëhet në ato rrethana duhet të jetë realist dhe proporcional. Në veçanti, Misioni shpjegon se efekti i kombinuar i një numri të madh të lëndëve dhe burimeve të kufizuara kishte bërë që Misioni t'ju jepte përparësi 1200 dosjeve të lëndëve të emërtuara 'krime lufte' nga UNMIK-u ndaj 'dosjeve të personave të zhdukur' - dhe, brenda kategorisë së mëparshme, rastet që shfaqeshin 'më premtuese për sa i përket rezultateve të hetimit'.

31. Në lidhje me detyrën e vet për të mbajtur të informuar të afërmit e të zhdukurve, Misioni tha si më poshtë:

‘Misioni pranon që, me qëllim t’i menaxhoj pritjet në mënyrë sa më adekuate dhe transparente, duhet të kishte bërë më shumë për t’i mbajtur të afërmit dhe publikun më të gjerë të informuar në lidhje me zbatimin e mandatit të tij, si dhe kufizimet e veta. Sidoqoftë, në rastin konkret dhe duke marrë parasysh pengesat themelore të paraqitura, Misioni nuk beson se të drejtat e ankuesit janë shkelur’.

32. Lidhur me ndryshimin e mandatit të Misionit dhe efektin e tij në këtë rast, Misioni tregoi se mban kapacitet ekzekutiv për të mbështetur Institutin e Kosovës për Mjekësi Ligjore në kryerjen e aktiviteteve të tilla si vlerësimet në vend, zhvarrosjet dhe gërmimet dhe mbetet në dispozicion nëse del në dritë ndonjë informacion i ri i besueshëm.
33. Misioni gjithashtu jep një përshkrim të përgjithshëm të aktiviteteve të veta të monitorimit, d.m.th., vërejtjet dhe raportimi i tij mbi rastet që trajtohen nga autoritetet vendore, megjithëse nuk sugjeron që aktualisht është duke monitoruar këtë rast.

IV. SHQYRTIMET

Rëndësia e të drejtave të mbrojtura dhe interesave

34. Si çështje paraprake, Paneli dëshiron të nënvizojë faktin se të drejtat në fjalë në rastet e zhdukjes me forcë janë ndër më të rëndësishmet nga të gjitha të drejtat themelore të njeriut. Në veçanti, raste të tilla shpesh përfshijnë çështje që kanë të bëjnë me të drejtën e jetës, të drejtën për të mos iu nënshtruar trajtimit mizor dhe çnjerëzor, të drejtën për të vërtetën, të drejtën e respektimit të jetës familjare dhe të drejtën për të pasur qasje në drejtësi.
35. Natyra dhe shtrirja e masave që duhet të zbatohen nga autoritetet kompetente për të garantuar mbrojtjen efektive të këtyre të drejtave, duhen të jenë në përpjesëtim dhe të maten në lidhje me rëndësinë që i kushtojnë këtyre të drejtave dhe interesave themelore që ata kërkojnë të mbrojnë.

Kryerja e një vlerësimi real të veprimeve të Misionit

36. Të drejtat dhe interesat e mbrojtura nga nenet 2 dhe 3 të Konventës duhet të sigurohen dhe garantohen në të gjitha rastet. Sidoqoftë, rrethanat në të cilat duhet të bëhet kjo mund të ndikojnë në atë që mund të bëhet në praktikë dhe, prandaj, çfarë mund të pritët në mënyrë të arsyeshme nga autoritetet. Si rezultat, përderisa mundësitë vështirë se mund të ishin më të mëdha për viktimat, një vlerësim i sjelljes së autoriteteve kur kërkojnë të mbrojnë të drejtat e tyre duhet të shpjegojnë rrethanat përkatëse në të cilat ato autoritete e gjetën veten në atë kohë. Sidoqoftë, vështirësitë që lidhen me rrethanat që mbizotëronin në atë kohë - për shembull, një situatë konflikti ose një situatë pas konfliktit - duhet të dallohen qartë nga çështjet që kanë të bëjnë me burimet në dispozicion. Ndërsa autoritetet nuk janë përgjegjës për të parën dhe duhet të bëjnë sa më mirë që munden në rrethanat në atë kohë, këto të fundit nuk japin asnjë arsyetim të vlefshëm për t’u tërhequr nga detyrimet ndaj të drejtave të njeriut. Përkundrazi, është përgjegjësia e atyre autoriteteve të sigurojnë që burimet të jenë të organizuara, shpërndara dhe përdoren në mënyrë të tillë që të sigurojnë që obligimet e veta ndaj të drejtave të njeriut të mbahen dhe të drejtat përkatëse të mbeten efektive.
37. Prandaj, pritjet e vendosura mbi aftësinë e EULEX-it për të hetuar dhe zgjidhur çështje komplekse kriminale duhet të jenë realiste dhe të mos i vendoset Misionit ndonjë

ngarkesë disproporcionale që mandati dhe burimet e tij nuk janë në gjendje ta përmbushin. Shih, në përgjithësi, *U.F. Kundër EULEX-it*, 2016-12, Vendim dhe gjetje, 12 shkurt 2020, paragrafi 60; *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, 11 nëntor 2015, par. 43-45; *A, B, C, D kundër EULEX-it*, 2012- 09 deri 2012-12, 20 qershor 2013, paragrafi 50; *K deri T kundër EULEX-it*, 2013-05 deri 2013-14, 21 prill 2015, para. 53; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendim mbi pranueshmërinë, 29 shtator 2015, paragrafë. 35-37; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, Vendim për pranueshmërinë, 30 shtator 2015, paragrafë. 72-74; shih gjithashtu Panelin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të Vendimit të UNMIK-ut (HRAP) në lëndën nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, par. 35 dhe paragrafët 70-71.

38. Në mënyrë të veçantë, Misioni i EULEX-it nuk është shtet dhe aftësia e tij për të garantuar mbrojtje efektive të të drejtave të njeriut nuk mund të krahasohet në të gjitha aspektet përkatëse me atë që mund të pritët nga një shtet (shih p.sh., vendimi i Panelit në *A, B, C, D kundër EULEX-it*, 2012-09 deri 2012-12, 20 qershor 2013, paragrafi 50; *K deri T kundër EULEX-it*, cituar më lart, paragrafi 53; shiko gjithashtu Vendimin e PKDNj-së në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, paragrafi 35; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, paragrafi 49).
39. Në lidhje me këtë, Paneli vëren se detyra që iu dha Misionit në shumë aspekte ishte marramendëse. Numri i rasteve për të cilat pritej të hetoheshin ishte jashtëzakonisht i madh dhe ato raste ishin komplekse. Burimet e vëna në dispozicion të tij ishin në shumë aspekte të pamjaftueshme dhe jo të duhura. Për më tepër, të dhënat e transmetuara në Mision nga UNMIK-u ishin në gjendje të dobët dhe kërkonin që Misioni të kalonte një sasi të konsiderueshme kohe dhe burimesh, thjesht duke u përpjekur t'i kuptonte ato.
40. Situata pas konfliktit në të cilën Misioni duhej të vepronte gjithashtu e ndërlikoi punën edhe më tej. Shih p.sh. *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, 11 nëntor 2015, par. 44 dhe referencat e cituara në të. Bashkëpunimi ishte shpeshherë më pak sesa më pas.
41. Paneli vëren se nenet 2 dhe 3 të Konventës janë të drejta të pakapërcyeshme sipas nenit 15(2) të Konventës. Sidoqoftë, siç u përmend më lart, ajo që autoritetet mund të pritët të bëjnë në një rast të caktuar për të siguruar këto të drejta do të varet pjesërisht nga rrethanat që mbizotërojnë në atë kohë. Në rastin konkret, Paneli është veçanërisht i vetëdijshëm për faktin se rrethanat pas konfliktit kishin pasoja praktike në aftësinë e Misionit për të kryer veprime në lidhje me ato që lidhen me mandatin e tij ekzekutiv. Prandaj, këto elemente dhe konsiderata janë marrë parasysh nga Paneli për të përcaktuar se çfarë, në ato rrethana, mund të pritët legjitimisht nga Misioni në lidhje me këtë rast.
42. Disa çështje paraprake duhet të trajtohen së pari këtu. Në parashtrësit e tij, Misioni vëren me saktësi se garancia e përfshirë në nenin 2 të Konventës Evropiane është një nga *mjetet* dhe jo *rezultat*. Kjo është me të vërtetë e saktë pasi një shtet ose autoritetet përkatëse nuk mund të fajësohen për dështimin për të mbrojtur të drejtat e një individi nëse ata kanë bërë çmos dhe atë që ligji pritët t'i mbrojë ato të drejta. Sidoqoftë, si detyrim i mjeteve, ligji pret që mjetet e investuara për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave themelore të jenë në përpjesëtim me rëndësinë e së drejtës në fjalë dhe peshën e shkeljes së mundshme që autoritetet kërkojnë të parandalojnë dhe korrigojnë. Në veçanti, në rastin *Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç kundër Turqisë* (Aplikacioni nr. 24014/05, Aktgjykimi, 14 prill 2015 (Dhoma e Madhe), paragrafët 172, të cilat Paneli miratoi në lëndën nr. 2016-12 (paragrafi 63)), Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut tha këtë:

172. Në mënyrë që të jetë "efektive" pasi kjo shprehje do të kuptohet në kontekstin e nenit 2 të Konventës, fillimisht një hetim duhet të jetë adekuat (shih *Ramsahai dhe të tjerët kundër Holandës* [GC], nr. 52391/99, § 324, KEDNj 2007 II). Kjo do

të thotë, ajo duhet të jetë e aftë të çojë në vërtetimin e fakteve dhe aty ku është e përshtatshme, identifikimin dhe dënimin e atyre që janë përgjegjës.

173. Detyrimi për të kryer një hetim efektiv është një detyrim jo i rezultatit por i mjeteve: autoritetet duhet të marrin masat e arsyeshme në dispozicion të tyre për të siguruar prova në lidhje me incidentin në fjalë (shih *Jaloud kundër Holandës* [GC], nr. [47708/08](#), 186 §, KEDNj 2014; dhe *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* [GC], nr. [43577/98](#) dhe [43579/98](#), 160, ECHR 2005 VII).

174. Në secili rast, autoritetet duhet të ndërmarrin çfarëdo hapa të arsyeshëm për të siguruar provat në lidhje me incidentin, duke përfshirë, *ndër të tjera*, dëshminë e dëshmitarit okular, provat mjekoligjore dhe kur është e përshtatshme, një autopsi e cila siguron një regjistrim të plotë dhe të saktë të dëmtimit dhe një analizë objektive të gjetjeve klinike, përfshirë shkakun e vdekjes. Çfarëdo mangësie në hetim që dëmton aftësinë e tij për të përcaktuar shkakun e vdekjes do të rrezikojë që personi përgjegjës të bie ndesh me këtë standard (shih *Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë* [GC], nr. [23458/02](#), § 301, KEDNj 2011)

Paneli do t'i marrë parasysh këto konsiderata gjatë vlerësimit të përgjigjes së Misionit në këtë rast.

43. Paneli gjithashtu do të shqyrtojë nëse ka pengesa konkrete dhe reale që mund të kishin minuar mundësinë e EULEX-it për të kryer një hetim të shpejtë dhe efektiv të një lënde. Një vlerësim i tillë nuk ka për qëllim të justifikojë mangësitë operationale që nuk lidhen me sfidat konkrete dhe të demonstrueshme, as të ndikojë në standardin në të cilin Misioni duhet të mbahet në bazë të detyrimeve të tij ndaj të drejtave të njeriut. Shih *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, 11 nëntor 2015, par. 44; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, 30 shtator 2015, par. 73-74; dhe *K, L, M, N, O, P, Q, R, S&T (K deri T) kundër EULEX-it*, 2013-05 deri 2013-14, 21 Prill 2015, par. 54; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, 19 tetor 2016, par. 31; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., dhe I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, 19 tetor 2016, par. 57.

Mungesa e hetimit

44. Në rastin konkret, nuk kishte asnjë hetim nga Misioni, intervistë të dëshmitarëve ose të të afërmeve, kërkesë për dokumentacion, kontakte me UNMIK-un, ose ndonjë përpjekje të dukshme për të marrë dokumente që UNMIK-u kishte mbledhur në lidhje me të. Siç u diskutua më poshtë, nuk kishte gjithashtu asnjë kontakt, ose përpjekje për kontakt me të afërmit e të zhdukurve.
45. Arsyeja e avancuar nga Misioni për këtë situatë është se ajo u dha përparësi lëndëve që ishin "më premtuese në lidhje me rezultatin hetimor". Paneli e konsideron një argument të tillë problematik për një numër arsyesh.
46. Së pari, e drejta për një hetim në rastet e zhdukjes me forcë nuk është opsionale dhe është e pakushtëzuar. Misioni nuk ka arritur të shpjegojë pse ankuesi do të kishte më pak të drejtë për të vërtetën dhe drejtësinë sesa çdo viktimë tjetër në të njëjtin pozitë.
47. Së dyti, konsideratat praktike (siç është numri i lëndëve dhe burimet e kufizuara të autoriteteve në fjalë) mund të nënkuptojnë që disa raste mund të kenë përparësi ndaj të tjerëve. Megjithatë kjo në asnjë rrethanë nuk e heq thelbin e asaj të drejte, d.m.th., nuk e heq ose zvogëlon obligimin për të kryer një hetim efektiv. Edhe kur mbizotërojnë rrethana të vështira, autoriteti duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e arsyeshëm sipas rrethanave. Prandaj, kur një hetim është përkohësisht i pamundur, duhet të vendosen mjete dhe

mekanizma të tjerë për të siguruar që të drejtat në fjalë të ruhen sa duhet dhe esenca e tyre të garantohet. Në veçanti, duhet të merren hapa për të siguruar që mundësia e një hetimi, edhe nëse vonohet, të ruhet dhe të mos humbet për shkak të vonesave për nisjen zyrtare të tij.

48. Në këtë rast, Paneli vëren se mungesa e hetimit ishte shtuar nga mungesa e komunikimit me të afërmit e të zhdukurve. Për më tepër, Misioni nuk ndërmori asnjë hap për të siguruar mjete alternative për të lehtësuar efektin e kësaj mungese të hetimit ndaj të të drejtave të tyre. Prandaj, "përparësia" e tij rezultoi në një mungesë të plotë të hetimit, korrigjimit dhe të vërtetës për sa i përket këtij rasti. Paneli vëren në këtë kontekst se situata pas konfliktit në të cilën Misioni duhej të vepronte në asnjë mënyrë nuk e pengoi Misionin të bënte këto gjëra. As mungesa e burimeve nuk duket se jep një shpjegim të vlefshëm qoftë edhe që ta hetonte këtë rast.
49. Në këtë drejtim, Paneli do të dëshirojë të shtojë sa vijon. Së pari, ishte përgjegjësia e Misionit të sigurojë që ajo të organizohej vetë dhe të shpërndante burimet e veta në një mënyrë në përputhje me detyrimet e tij ndaj të drejtave të njeriut. Si mision 'i sundimit të ligjit', është e qartë se përgjegjësitë që kanë të bëjnë me shtetin e së drejtës duhet të kenë qenë përparësi institucionale dhe operative. Së dyti, kur është e nevojshme për të dhënë përparësi disa aktiviteteve ndaj të tjerave, duhet të kishte siguruar, të paktën, që (a) ishte hartuar dhe publikuar një strategji dhe politikë e qartë për këtë qëllim (dhe që, për dijeninë e Panelit, nuk ekzistonte kurrë) dhe (b) ajo përparësi nuk ka rezultuar në braktisjen e detyrimeve të tij ndaj të drejtave të njeriut, në veçanti në lidhje me ato të drejta që janë me karakter absolut. Duke marrë parasysh që Misioni po zëvendësonte autoritetet vendore në shumë prej përgjegjësive të tij ekzekutive, i mbetej Misionit që të sigurohej që kjo të bëhej në përputhje të plotë me ato përgjegjësi të të drejtave të njeriut që ishin të lidhura me atë rol. Mungesa e burimeve nuk ofron asnjë arsytim për dështimin për ta bërë këtë. Nëse ndonjë gjë, kjo do të kishte dashur që Misioni të kërkonte burime që i mungonin ose, kur kjo refuzohej, të bënte publikisht të qartë dhe sinqerisht faktin që do të ishte në gjendje të merrej vetëm me një grup të ngushtë përgjegjësish ekzekutive. Transparenca, ndërsa nuk është një zëvendësim për kryerjen e një hetimi efektiv ose përmbushjen e detyrimeve të tjera ndaj të drejtave të njeriut, është me të vërtetë një element i rëndësishëm i përgjegjësisë dhe viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut kishin të drejtë të dinin se çfarë Misioni ishte me të vërtetë i aftë të bënte për të korrigjuar shkeljet e të drejtave të tyre. Ndërsa sfiduese, situata pas konfliktit në të cilën Misioni duhej të vepronte nuk jep një shpjegim të kënaqshëm për dështimin në shkallë të gjerë për të trajtuar raste të këtij lloji. Megjithatë Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ka sqaruar - në lidhje me shtetet - që obligimet ndaj të drejtave të njeriut duhet të përmbushen edhe në kontekstin e një konflikti të armatosur në vazhdim, duke përfshirë kërkesat procedurale sipas nenit 2 të Konventës për të kryer një efektiv hetim (shih, p.sh., *Al-Skeini kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aplikacioni nr. 55721/07, Aktgjykim, 7 korrik 2011; *Jaloud kundër Holandës*, Aplikacioni nr. 47708/08, Aktgjykim, 20 nëntor 2014).
50. Mosarritja e Misionit për të trajtuar raste të tilla si kjo këtu mund të ketë qenë prekur nga burimet e tij të kufizuara dhe nga sfidat e paraqitura nga situata pas konfliktit në të cilën duhej të vepronte. Por një dështim për të planifikuar siç duhet dhe për të zhvilluar strategji të hollësishme dhe transparente për t'u marrë me ato raste është të paktën nëse nuk është më domethënësja shpjegimi i faktit se lënda në fjalë nuk është hetuar dhe se nuk është bërë asnjë përpjekje për t'i kontaktuar viktimat.
51. Së treti, përderisa prioritizimi i lëndëve mund të jetë i arsyeshëm kur rastet që kërkojnë veprime të autoriteteve janë të shumta për kapacitetet e tij, vendimi për përparësi duhet të paktën të përmbushë dy kritere themelore. Së pari, ajo nuk duhet të diskriminojë në baza të palejueshme, të ndaluara me ligjin për të drejtat e njeriut. Në përgjithësi shih nenin 14 KEDNJ; nenet 2 dhe 7 Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut; nenet 4 (1) dhe 26

ICCPR; dhe neni 1 (3) i Kartës së KB-së. Së dyti, siç u bë e qartë nga GjEDNj-ja (cituar, më lartë në paragrafin 30), obligimi për të kryer një hetim efektiv kërkon që autoritetet të marrin masat e arsyeshme në dispozicion të tyre për të siguruar prova në lidhje me incidentin në fjalë (*Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç kundër Turqisë*, Kërkesa nr. 24014/05, Aktgjykim, 14 prill 2015 (Dhoma e Madhe), paragrafët 173-174). Në këtë rast, Misioni nuk u përfshi në asnjë proces të mbledhjes së provave. Në fakt, ai madje as edhe nuk i kërkoi UNMIK-ut apo autoriteteve të tjera dosjet 'e fjetura' që ata kishin ose mund të kishin në zotërimin e tyre. Kjo e çon Panelin drejt shqetësimit të katërt që lidhet me rrjedhën e veprimet të ndërmarrë nga Misioni.

52. Së treti, siç u cek më lart, nga PSRK-ja iu rekomandua Misionit që kjo lëndë të hetohej. Prandaj, nuk ishte vetëm një detyrë e të drejtave të njeriut për ta bërë këtë, por edhe një bazë e mjaftueshme që lënda të hetohej. Për të shpjeguar mos realizimin e atij rekomandimi, Misioni sugjeron që duhej t'iu jepte përparësi lëndëve që shfaqeshin 'më premtuese në lidhje me rezultatet e hetimit'. Në mungesë të ndonjë hetimi paraprak të kësaj lënde (shih paragrafët 48 dhe 49), Paneli nuk është i bindur që një vlerësim i tillë mund të ishte kryer në mënyrë të drejtë, në mënyrë të përditësuar dhe në një mënyrë që të garantonte mbrojtjen efektive të të drejtave të palëve. Paneli nuk është i bindur se Misioni mund të ketë qenë në gjendje të bënte një vlerësim të tillë pa kërkuar dosjen e UNMIK-ut dhe pa kryer ndonjë intervistë ose kontakt me ata që janë më të afërmit e të zhdukurve. Prandaj, Paneli nuk është i bindur që vlerësimi i përparësisë së Misionit bazohej në një bazë të mjaftueshme dhe të besueshme për të siguruar dhe garantuar të drejtat e palës.
53. Së katërti, para se të bënte thirrjen e gjykitimit të mësipërm që do të kishte pasoja të tilla të rëndësishme për të drejtat e ankuesit, Misioni do të duhet të pritej nga arsyeja që të kërkonte ndihmën dhe bashkëpunimin e autoriteteve të tjera nëse dhe kur kjo e fundit mund të kishte në zotërimin e tyre informacion dhe/ose burime me rëndësi për përpjekjet e mëparshme për të kryer një hetim efektiv. Në përgjithësi shih *U.F. kundër EULEX-it*, 2016-12, Vendim dhe gjetje, 12 shkurt 2020, paragrafi 64, duke iu referuar: Lënda *Güzelyurtlu dhe të tjerët kundër Qipros dhe Turqisë*, Aplikacioni nr. 36925/07, Aktgjykim, 29 janar 2019, paragrafët 229 dhe 232-233. Misioni nuk arriti t'u tregojë atyre informacion (potencial) për këtë rast dhe nuk ka dhënë asnjë shpjegim për atë dështim.
54. Në bazë të asaj që u përmend më sipër, edhe sikur Misioni të ishte i autorizuar t'iu jepte përparësi rasteve të caktuara të kësaj natyre (të paktën përkohësisht), ai nuk ka vepruar në këtë rast në atë mënyrë që të jetë në përputhje me ruajtjen efektive të të drejtat e ankuesit. Mosarritja e plotë e tij për të hetuar këtë rast dhe për të ndërmarrë madje edhe hapat më themelorë për të pasur në dispozicion të gjithë informacionin në dispozicion para se të vendosej të mos hetohej, përbën një shkelje serioze të obligimeve të tij ndaj të drejtave të njeriut sipas nenit 2 (pjesa procedurale) dhe 3 i Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo vë në pah mungesë zelli dhe korrektësie në ushtrimin e një elementi kritik të mandatit të tij.

Mos informimi i të afërmeve të ngushtë të të zhdukurit

55. Ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut kërkon që në një rast të tillë si ky këtu, të afërmit e të zhdukurve të informohen sa duhet për rrjedhën e hetimit të rastit dhe rrjedhën e procedurës. Në përgjithësi shih *U.F. kundër EULEX-it*, 2016-12, Vendim dhe gjetje, 12 shkurt 2020, paragrafi 97; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 66; *Desanka dhe Zoran Stanisić kundër EULEX-it*, 2012-22, 11 nëntor 2015, par. 66; *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, 11 nëntor 2015, par. 60-61, 72-73; PShDNj, Shënim i Ligjit mbi Detyrën për Hetimin e Akuzave të Shkeljeve të të Drejtave, faqe 28-30; shih gjithashtu *Ahmet kanzkan dhe të tjerët kundër Turqisë*, Aplikacioni nr. 21689/93, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 6 prillit 2004, par. 311-314, *Isayeva kundër*

Rusisë, Aplikacioni nr. 57950/00, Aktgjykimi i GjEDNj-së i 24 shkurtit 2005, par. 211-214; *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aplikacioni nr. 55721/07, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 7 korrik 2011, par. 167.

56. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë që të afërmit mund të kontribuojnë dhe marrin pjesë në mënyrë të konsiderueshme dhe kërkon të zvogëlojë tensionin dhe dhimbjen e mos njohjes së asaj që i ka ndodhur të dashurit të tyre. Shih gjithashtu *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 66; *U.F. kundër EULEX-it*, 2016-12, Vendim dhe gjetje, 12 shkurt 2020, paragrafi 96.
57. Obligimi për të mbajtur viktimat të informuar në lidhje me përpjekjet hetimore është veçanërisht i rëndësishëm në një rast që përfshin akte të zhdukjes me forcë pasi të afërmit e mbijetuar mund të mos kenë asnjë burim tjetër informacioni në lidhje me fatin e të afërmeve (të) tyre dhe ata do të vazhdojnë të jetojnë me shpresën që fati i të afërmeve (të) të tyre një ditë do të sqarohet. Si rezultat, të afërmit e afërt të viktimave të zhdukur vuajnë emocionalisht nga mungesa e informacionit në lidhje me fatin e të dashurit të tyre. Shih *U.F. kundër EULEX-it*, 2016-12, Vendim dhe gjetje, 12 shkurt 2020, paragrafi 98; *Zufe Miladinović kundër EULEX-it*, 2017-02, 19 qershor 2019, para. 87; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 78. Një kërkesë e tillë është një element i domosdoshëm i mbrojtjes së të drejtave të viktimave në hetimin e një rasti të tillë. Shih, p.sh., *U.F. kundër EULEX-it*, 2016-12, Vendim dhe gjetje, 12 shkurt 2020, paragrafi 98; *H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 77; *Desanka dhe Zoran Stanisić kundër EULEX-it*, 2012-22, 11 nëntor 2015, par. 66, duke iu referuar *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, 11 nëntor 2015, par. 60-61, 72-74; *Zufe Miladinović kundër EULEX-it*, 2017-02, 19 qershor 2019, par. 86; shih gjithashtu *Ahmet kanžkan dhe të tjerët kundër Turqisë*, Aplikacioni nr. 21689/93, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 6 prill 2004, par. 311-314, *Isayeva kundër Rusisë*, Aplikacioni nr. 57950/00, Aktgjykimi i GjEDNj-së i 24 shkurtit 2005, par. 211-214; *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aplikacioni nr. 55721/07, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 7 korrik 2011, par. 167.
58. Autoritetet kompetente nuk do të lejohen të mos respektohet ose injorohet ky obligim. Shih *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 67; *U.F. kundër EULEX-it*, 2016-12, Vendim dhe gjetje, 12 shkurt 2020, paragrafi 98.
59. Paneli gjithashtu vëren se e drejta për të vërtetën në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut nuk është vetëm një e drejtë individuale. Ajo është po ashtu një e drejtë kolektive, që shërben për të ruajtur kujtesën në nivelin e shoqërisë dhe duke vepruar si një mbrojtje kundër përsëritjes së shkeljeve. Shih *Komenti i Përgjithshëm mbi të Drejtën për të Vërtetën në Marrëdhënien ndaj Zhdukjes me forcë; Raporti i Grupit të Punës për Zhdukjet me forcë ose të pavullnetshme (2010)*, Dokumenti A/HRC/16/48, Parathënia. Në kontekstin pas konfliktit të Kosovës, hetimet e zhdukjeve me forcë kontribuan - dhe vazhdojnë të kontribuojnë - në promovimin e së vërtetës, në kujtesën kolektive të shkeljeve të tilla të të drejtave të njeriut dhe për të siguruar që ato mos të përsëriten.
60. Në pyetjen nëse të afërmit e z. Avramović ishin të përfshirë në hetimin e këtij rasti dhe nëse ata ishin intervistuar nga Misioni, Misioni tha që ankuesi ka dhënë deklaratat në KFOR në qershor 1999 dhe në Stacionin e Policisë së UNMIK-ut në Mitrovicë në dhjetor 1999. Dhe në qershor 2004, ankuesi dhe babai i të zhdukurit ishte intervistuar nga Njësia e Personave të Zhdukur të UNMIK-ut. Vetë Misioni nuk kishte asnjë kontakt me ankuesin ose të afërmit e z. Avramović.
61. I pyetur nga Paneli pse Misioni nuk kërkoi të kontaktonte të afërmit e të zhdukurve, Misioni u përgjigj se pasi që nuk mund të përcillte kërkesën e hetimit të vitit 2009, ai nuk kërkoi t'i kontaktonte ata. Paneli e konsideron këtë shpjegim jo të kënaqshëm. Edhe nëse vendimi

i Misionit për të kryer hetim të ishte pranuar, kjo nuk i ka dhënë mundësi obligimit të tij që të mbajë të afërm të informuar pasi ato reflektojnë dy detyrime të ndara që dalin nga e njëjta e drejtë. Përkundrazi, mungesa e informacionit nga ana e Misionit mund të ketë vazhduar të ushqejë shpresën e familjes që çështja përfundimisht do të sillet para drejtësisë, ashtu siç kishin të drejtë të pritnin.

62. Lidhur me mundësinë që Misioni të informojë të afërmit për ata që u zhdukën, dosja e të cilëve u ishte bartur autoriteteve vendore, kosovare, Misioni tha që nuk konsideronte se ishte e nevojshme ta bënte këtë. Për më tepër, Misioni ka parashtruar: 'kjo gjithashtu do të ishte një detyrë e pamundur administrative për t'u kryer deri në afatin e fundit të dhjetorit 2018'. Përsëri, Paneli nuk është i bindur. Një hap i tillë do të kishte shkuar në një farë mënyre duke përbushur detyrimin e Misionit për të informuar ankuesin dhe mund të kontribuonte, megjithëse në një shkallë të kufizuar, në të drejtën e tyre për të vërtetën. Sa i përket "pamundësisë" së detyrës administrative, Paneli nuk është i bindur se mund të kishte ndonjë vështirësi të pakapërcyeshme që do të kishte penguar Misionin ta bëjë këtë. Ky shpjegim është pra jo bindës.
63. Detyra e përshkruar më sipër nuk është opcionale dhe është e rëndësishme. Përpjekjet e vendosura nga Misioni për ta përbushur atë - ose, përkundrazi, mungesa e tyre - nuk pasqyrojnë rëndësinë e interesave që ishin në diskutim. Dështimi i Misionit do të kontribuonte më tej për ta lënë ankuesen në një gjendje të pasigurisë që do të kontribuonte në shkaktimin e shqetësimit të saj emocional.
64. Bazuar në çfarë u tha më sipër, Paneli konstaton se Misioni nuk ka përbushur obligimin e tij për të informuar ankuesin ashtu siç kërkohet të bënte, dhe duke bërë kështu, ka shkelur të drejtat e saj themelore siç garantohen në nenet 2 (pjesa procedurale) dhe 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.
65. Në bazë të gjetjeve të Panelit në lidhje me nenet 2 dhe 3 të Konventës, nuk është rreptësisht e nevojshme që Paneli të bëjë gjetje specifike në lidhje me të drejtat e garantuara në nenin 8 të Konventës. Sidoqoftë, Paneli dëshiron të nxjerrë në pah faktin se një nga pasojat më serioze të shkeljes së të drejtave të ankueses i përket jetës së saj familjare. Për dy dekada, ajo ka jetuar pa bashkëshortin e saj, dhe pa mbështetjen e tij emocionale dhe financiare, të përbërë nga pasiguria e dhimbshme e fatit të tij. Prandaj, e drejta e saj për të respektuar jetën e saj familjare është prekur qartas nga situata.

E drejta për një mjet efektiv juridik

66. Ky rast pasqyron një realitet shumë më të gjerë dhe një problem më të madh institucional, të cilin Paneli e ka vërejtur këtu dhe në rastet e tjera që janë paraqitur para tij. Të dhënat e këtyre procedurave sugjerojnë që shumica e rasteve të zhdukjes me forcë që datojnë nga konflikti i Kosovës dhe pasojat e tij kanë mbetur të pa hetuara dhe të pazgjidhura. Ato së pari kanë hyrë nën përgjegjësinë e Kombeve të Bashkuara. Pastaj të EULEX-it Kosovë. Dhe tani tek autoritetet vendore, të Kosovës. Me gjithë përfshirjen e autoriteteve të shumta gjatë dy dekadave, shumica e këtyre rasteve kanë mbetur të pa hetuara ose në një gjendje të rëndë. Si rezultat, viktimat kanë pasur pak drejtësi dhe të vërtetë, dhe pak qartësi mbi atë që ishte bërë nga ata që kishin përgjegjësi të vepronin për të mbrojtur dhe garantuar të drejtat e tyre.
67. Në çdo fazë, viktimat do të kishin të drejtë të besonin, të prisnin dhe të shpresonin që autoritetet e reja do të bënin më mirë se ato të mëparshmet. Ata duhet të kenë qenë të zhgënjyer shumë që shpresat e tyre nuk u realizuan. Shumica e rasteve të zhdukjes me forcë mbeten, tejet shumë dhe në mënyrë të pafalshme, të pa hetuara. Tekstualisht qindra prej tyre kaluan nëpër duart e EULEX-it Kosovë pa u hetuar.

68. Kur u pyetën për gjendjen aktuale të disa prej rasteve - përfshirë atë këtu - që kaloi 10 vjet nën përgjegjësinë e EULEX-it, Misioni fton ankuesin përmes Panelit të shkojë dhe të pyesë autoritetet e Kosovës. Sidoqoftë, të drejtat e njeriut nuk janë ndonjë kovë që autoritetet duhet të kalojnë nga njëra tek tjetra. EULEX-i Kosovë kishte, për një dekadë, përgjegjësinë për të hetuar këto raste - përfshirë edhe këtë - dhe nuk arriti ta bëjë këtë. Tani ajo duhet t'i riparojë pasojat e veprimeve dhe vendimeve të veta.
69. Në bazë të kësaj, Paneli konsideron se Misioni ka shkelur dhe aktualisht po shkel një të drejtë tjetër të ankuesit, përkatësisht të drejtën e saj për një mjet efektiv juridik, siç është e garantuar, ndër të tjera, me nenin 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, nenin 8 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe nenin 2(3) të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Shih gjithashtu *Kudla kundër Polonisë*, Aplikacioni nr. 30120/96, Aktgjykim, 26 tetor 2000, në veçanti, par. 152.
70. Paneli fton shefin e Misionit t'i marrë me kujdes pasojat e këtyre gjetjeve dhe cilat masa duhet të zbatohen për të siguruar një mjet efektiv juridik për shkeljen e të drejtave të ankuesit. Fakti që të drejtat e ankuesit janë shkelur për dy dekada, njëra prej të cilave nën përgjegjësinë e Misionit të EULEX-it, duhet të justifikojë që hapat e ndërmarrë duhet të jenë të tillë që të pasqyrojnë rëndësinë dhe kohëzgjatjen e këtyre shkeljeve, si dhe nevojën për efektivitet në korrigjimin e tyre. Në përgjithësi shih *Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aplikacioni nr. 7552/09, Aktgjykim, 4 mars 2014, në veçanti, par. 41; *Husayn (Abu Zubaydah) kundër Polonisë*, Aplikacioni nr. 7511/13, Aktgjykim, 24 korrik 2014, paragrafi 540; *Kaya kundër Turqisë*, Aplikacioni nr. 158/1996/777/978, Aktgjykim, 19 shkurt 1998, par. 106; *Mahmut Kaya kundër Turqisë*, Aplikacioni nr. 22535/93, Aktgjykim, 28 mars 2000, në veçanti, par. 124.

Të tjera

71. Në prill 2018, dosja e lëndës që i përket z. Avramović iu dorëzua institucioneve kompetente të Kosovës. Shënimi i dorëzimit të dosjes adresuar kryeprokurorit (asokohe) të ZRPK-së përmbante një ftesë që të bëhej një ndërlidhje me NjHKL-në e EULEX-it në lidhje me veprimet e ndërmarra rreth kërkesës për të kryer një hetim të korrikut 2009.
72. Nuk ka asnjë tregues për nisjen e ndonjë hetimi nga autoritetet vendore në lidhje me këtë rast.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

KONSTATON se Misioni ka shkelur të drejtat themelore të ankuesit ashtu siç garantohen në nenet 2 (pjesë procedurale), 3 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;

KOSTATON MË TEJ që shkeljet janë serioze dhe në vazhdim e sipër, dhe prandaj ato kërkojnë zbatimin e masave korrigjuese në përpjesëtim me to;

FTON SHEFIN E MISIONIT, në veçanti, që të marrë parasysh këto që vijojnë:

- i. Të pranoj shkeljen e të drejtave të ankueses nga ana e Misionit;
- ii. Të ofroj një kopje të këtij vendimi tek
 - a) organet përkatëse të Misionit,
 - b) autoritetet përkatëse politike në Bruksel dhe, tek
 - c) autoritetet vendore kompetente për të hetuar këtë rast;

- iii. Të urdhëroj që kjo lëndë të monitorohet nga organet kompetente të Misionit;
- iv. Të pyeten autoritetet vendore kompetente se çfarë hapash, nëse ka pasur, janë ndërmarrë për të hetuar këtë rast dhe cilat hapa të ardhshëm janë duke u planifikuar;
- v. Të kontaktohet ankuesja me qëllim të gjetjes së një mënyre për të korrigjuar shkeljen e të drejtave të saja.

Për Panelin,

Guénaël METTRAUX
Kryesues

Anna BEDNAREK
Anëtare

Anna AUTIO
Anëtare